



Dhuna shtëpiake

Masa për mbrojtje



Përmbajtje

- I. Masa për mbrojtje pas ligjit për mbrojtjen para dhunës (GSG)
 - Mbrojtje Pyetje 1

 - Masa për mbrojtje
(dëbim, ndalim hyrje ose ndalim kontakti) Pyetjet 2-30

 - Kërkesë për zgjatje e masave për mbrojtje GSG Pyetjet 31-36

 - Ruajtje Pyetjet 37-38

- II. Masa për mbrojtje gjate hetimit penal Pyetjet 39-41

- III. Masa për mbrojtje në procese martesë dhe partneriteti Pyetjet 42-43

- IV. Numrat e telefonit dhe adresat

Dëftues botimi

IST Ndërhyrje kundër dhunës shtëpiake

Co-Udhëheqës Franziska Greber, Cornelia Kranich

Drejtorja për drejtësi dhe e brendshëm

Neumühlequai 10, Postfach, 8090 Zürich

Email: ist@ji.zh.ch

www.ist.zh.ch

në bashkëpunim me

trupin e bashkëpunimit strategjik kundër dhunës shtëpiake të kantonit Cyrih

Krijim: Daniel Lienhard, Zürich / kdmz

Fotot: Franziska Greber

Dhjetor 2011

I. Masa për mbrojtje pas ligjit për mbrojtjen para dhunës (GSG)

Mbrojtje

1 Kush është i mbrojtur nga ligji para dhunës shtëpiake?

Ligji e mbron çdo person, që përjeton dhunë ose që kërcënohet me dhunë nga një person, i cili ka me atë marrëdhënie familiare ose partneriteti. Nuk luan rol a jetojnë ata ose kanë jetuar ata në ekonomi e shtëpisë të përbashkët ose a janë të ndarë. Ligji e mbron edhe atë person, që (ish-)partneri tij i zë pritë, e ndjek ose e bezdis me një mënyrë tjetër. Ligji mund edhe të thirret, nëse fëmijët ose të rinjtë përdorin dhunë kundër vëllezërive dhe motrave tyre ose kundër prindërve ose i kërcënohen atyre.

Masa për mbrojtje

(dëbim, ndalim hyrje ose ndalim kontakti)

2 Si mbron ligji?

Policia mund për mbrojtjen e personave të rrezikuar të urdhëroje masa speciale (masa për mbrojtje). Një person i cili rrezikon mundet të dëbohet për 14 ditë nga banesa ose nga shtëpia (dëbim pyetje 13ff) dhe/ose mund ti ndalohet hyrja në disa fusha (ndalim hyrje pyetje 14) dhe/ose mund ti ndalohet kontakti me disa persona (ndalim kontakti pyetje 15). Veç kësaj policia mund ta arrestoje një person i cili rrezikon për maksimal 24 orë (ruajtje pyetje 37).

3 Çfarë qëllimi kanë masat për mbrojtje?

Ata duhet ta ndalin situaten e dhunës akute dhe ti mbrojnë viktimat. Kështu situata qetësohet dhe të prekurit kanë mundësi, në qetësi ti mendojnë dhe ti verifikojnë hapat të ardhshëm.

4 Ku vlen ligji?

Ligji vlen në kantonin e Cyrihut. E shërben mbrojtjen e viktimave të dhunës shtëpiake, nëse ata banojnë ose punojnë ose ngjarja ndodh në kantonin e Cyrihut. Masat që i parasheh ligji mund të shprehën ndaj çdo personit i cili është „rrezikuës“, pa marrë parasysh ai ku e ka vendbanimin ose qëndrimin. Ligja të ngjashëm ka edhe në kantone tjerë (www.against-violence.ch).

5 Çfarë mund të bani ju, nëse jeni të prekur nga dhuna shtëpiake?

Lajmërohuni tek një konsultore ose një strehë për gra (të keqtrajtuara). Me një situatë rrezikut akut mundeni drejtpërdrejtë ta kërkonit Policin për mbrojtje dhe ndihmë (numrat e telefonit, adresat: faqe 10).

6 Si vepron Policia?

Policia ndihmon dhe e heton gjendjen faktike. Ajo mund ta dëbojë atë person i cili ka përdorur dhunë, a kërcënuar me dhunë ose ka bezdis për 14 ditë nga banesa ose nga shtëpia dhe rrethina e afër. Nëse për mbrojtjen e personit rrezikuar është e nevojshme, atëherë Policia mund ta ndalojë hyrjen në lagje ose rruga të përcaktuara (p.sh. vendi punës, rruga e shkollës) ose ta ndalojë kontaktin mes telefonit, SMS, letër etj. me personin e rrezikuar ose persona tjera të afër dhe prekur, veçanërisht fëmijë, që kanë nevojë për kujdesje.

7 Kush merr lajmë, që Policia ka urdhëruar një masë për mbrojtje?

Personi i cili rrezikon e merr urdhëresën e masës për mbrojtje nga Policia në një dispozitë me shkrim. Personi rrezikuar, konsultoret përgjegjës për keqberës dhe për viktimat e marrin nga një kopje. Nëse fëmijë jetojnë në ekonominë e shtëpisë, atëherë informohet edhe autoriteti për kujdestari.

8 Çfarë mund të bani ju, nëse keni si person i tretë dijeni për dhunë shtëpiake?

Ju mundeni ta kontaktoni një konsultore ose ta kërkonit drejtpërdrejtë Policin. Ju nuk jeni i/e detyruar. Si kujdestar ose shëndetësor ju keni mundësinë pa çlirim nga detyrimi për të heshtë në raste të lëndimeve trupor ta informoni Policin. Nëse është përdorur dhunë ndaj fëmijëve, mund të informohet gjithmonë autoriteti për kujdestari. Mësuesit kanë detyrën, ta informojnë drejtorin e shkollës. Në bazë të dëshirës zakonisht mund të garantohet anonimiteti i treguesit.

9 A është shprehja e një mase për mbrojtje kundër personit i cili rrezikon i varur nga vullneti i personit rrezikuar?

Jo. Nëse është integriteti trupor, seksual ose psikologjik i lënduar ose i rrezikuar nga veprimet dhunore, nga kërcënimet me dhunë ose përdorimi i dhunës, atëherë Policia duhet ta urdhërojë një masë për mbrojtje, pa e marrë parasysh vullnetin e personit rrezikuar.

10 A luajnë rol marrëdhëniat pronare ose të qiras?

Jo. Policia mund edhe atë person ta dëbojë, i cili është pronar ose qiraxhi i vetëm i shtëpisë ose i banesës tij.

11 Çfarë ndodh me çelësat e shtëpisë dhe me njoftimet zyrtarë të një personit dëbuar?

Personi dëbuar është i detyruar, të gjitha çelësat të banesës ose të shtëpisë me i dorëzuar. Ai duhet të ja tregojë Policiës një adresë, ku mundin të dërgohen lajmërimet zyrtarë të procesit

mbi mbrojtjen para dhunës. Nëse personi dëbuar nuk jep adresë, atëherë lajmërimet dërgohen në Polici dhe vlejné si të njoftuar.

12 Çfarë mund personi dëbuar të merr me vete?

Personit dëbuar i lejohet ti merr sendet e nevojëve personale urgjente (p.sh. dokumente personale, veshje, letërat njoftimi, ilaç, telefon dore, etj.). Për kohëzgjatjen e dëbimit duhet të sigurohen shpenzimet e jetesës të familjes. Një person më detyrim përkrahje duhet të lenë të holla ose kartë banke. Në shkak mosdhënie ndihme duhet të hapet një proces në gjykatën civile përgjegjës për përcaktimin e kontributit në shpenzime të jetesës.

13 Për cilën zonë vlen një dëbim?

Kjo masë vlen për banesën/shtëpin dhe për rrethinën e afër. Nën rrethinën e afër kuptohet p.sh. korridori, shkallët, bodrumi, lavanderia, oborri, kopshti, garazha dhe hyrja ose rruga hyrse.

14 Për cilën zonë vlen një ndalim hyrje?

Nëse policia urdhëron një ndalim hyrje, atëherë zona, ku nuk lejohet të hyret dhe qarkullohet, përshkruhet në masën për mbrojtje me një hartë. Një ndalim hyrje mundet të vlejje për disa rrugë dhe/ose lagje, nëse p.sh. vendi punës ose rruga e shkollës është e përfshirë.

15 Çfarë është një ndalim kontakti?

Një ndalim kontakti do të thotë, që personit i cili rrezikon i ndalohet në çdo mënyrë marrja e kontaktit me personin rrezikuar. Nën këtë kuptohet flasja drejtpërdrejtë, thirrjet telefonike, SMS, Email, letër, Facebook etj. Nëse për siguresën e mbrojtjes është e nevojëshme, ndalim kontakti mund të përhapet edhe në persona tjera (p.sh. fëmijët dhe të afërmit).

16 Çfarë ndodh me fëmijët ose të rinjtë që përdorin dhunë?

Ndalim kontakti dhe ndalim zone mund të urdhërohet edhe në veprime dhunore dhe veprime stalking, veçanërisht edhe në lidhje me cyberstalking. Dëbimi i miturit, që jeton në ekonomi e shtëpisë të njëjtë, është vetëm me pëlqimin e prindërve ose si masë penale për të rinjtë i mundur.

17 Çfarë mund të behët nëse masat për mbrojtje nuk ofrojnë mjaftë siguri?

Një gru e rrezikuar mund të merr me fëmijët e saj - pas marrëveshjes telefonike - strehim të përkohshëm me një strehë për gra (të keqtrajtuara). Për fëmijët dhe të rinjtë ekzistojnë institucione speciale për mbrojtje (numrat e telefonit, adresat: faqe 10). Nëse ka nevojë, policia ndihmon.

18 A mund një person i rrezikuar të mbrohet vetëm me masa për mbrojtje policore?

Me një situatë rrezikut akut Policia dhe autoritetet penale mundin ti zbatojnë masat shtrëngesë ndaj personit i cili rrezikon. Nëse rreziku nuk është akut, atëherë janë edhe ndërhyrjet ligjore, sociale dhe/ose terapeutike tjera të hapur. Kontaktoni një konsultore e specializuar për viktime ose një avokat ose një avokate.

19 A e humb një person i rrezikuar, që drejta e tij për qëndrim në Zvicër është e varur nga martesë ose partneriteti i regjistruar, drejtën për qëndrim në Zvicër me shprehje të një mase për mbrojtje?

Masat për mbrojtje nuk kanë ndikim tek drejta për qëndrim. Nëse vjen pas një kohe të shkurtur të martesës ose të partneritetit regjistruar në ndarje, divorc ose zgjidhje, atëherë personat, që nuk vijnë nga bashkësia evropiane, me qëndrim të devijuar nuk e humbin drejten për qëndrim në Zvicër vetëm në rastin, që përdorimi i dhunës kundër atyre mund të dëshmohej majftsisht nga aspekti drejtësisë dhe nese përdorimi i dhunës ka pasur një intensitet tillë, që vazhdimi i bashkësisë martesore mbetet i papranueshëm.

20 A mundin masat për mbrojtje policore të shprehën, nëse Policia me vonesë informohet për dhunën shtëpiake?

Po. Një masë për mbrojtje mund edhe atëherë të urdhërohet, kur personi rrezikuar me vonesë lajmërohet tek Policia, me kushtin që ai akoma duhet të ketë frikë para dhunës, kërcënimeve ose ndjekëve tjera.

21 Sa kushton një masë për mbrojtje?

Urdhërimi i një mase për mbrojtje nga Policia është falas.

22 A mund personi dëbuar të kthehet, nëse situata është qetësuar?

Jo. Edhe në rastin, që personi rrezikuar është dakord me kthimin, nuk i lejohet kjo personit dëbuar. Masa për mbrojtje ka për qëllim qetsimin dhe e siguron kohën për këshillë. Gjatë dëbimit prej 14 ditëve (dhe të zgjatjes gjyqësor tij) personi dëbuar nuk mund të kthehet. Personi dëbuar bëhet i dënueshëm, edhe në rastin që personi rrezikuar e lenë vullnetarisht në banesë/shtëpi. Nëse personi dëbuar ka nevojë për sendet e nevojëve personale urgjente që xhindën në banesë, ai ka të drejtë këto ti merr vetëm me pëlqimin e policisë dhe ndoshta ndër shoqërimin policor.

23 A vlen një masë për mbrojtje, nëse personi i cili rrezikon futët në burgim hetimor?

Po. Nëse personi i cili rrezikon lëshohet gjatë kohëzgjatjes së mases për mbrojtje nga burgimi hetimor, atëherë ai është i obliguar ti përmbahet mases për mbrojtje. Kjo domethënë që personi dëbuar nuk ka të drejtë të kthehet në shtëpi para të mbaroje masa për mbrojtje ose ta mosrespektojë ndalim hyrjen ose ndalim kontaktin (pyetje 41).

24 A mund kundër një mase për mbrojtje të bëhet një ankesë?

Mbasi personi i cili rrezikon e merr masen për mbrojtje, ai ka 5 ditë afat për ankesë. Gjykata për masa shtrënguese përgjegjës vendos mbrenda 4 ditëpunëve mbi parakushtet për urdhërimin. Dëri në vendim vlen masa për mbrojtje.

Kundër vendimit të gjykatës për masa shtrënguese mund të bëhet mbrenda 5 ditëve nga marrja/hapja e vendimit ankesa në gjykatën administrative Cyrih. Ankesa nuk ka efekt pezullues, dmth vendimi gjyqësor mbetet në fuqi dëri në vendimin e gjykatës administrative.

Nëse masa për mbrojtje vazhdon, atëherë personi i cili rrezikon i paguan shpensimet e procesit. Personi rrezikuar informohet me kohë për vendimin gjyqësor.

25 Çfarë mund personi rrezikuar të bëjë, nëse dëbimi, ndalim hyrja ose ndalim kontakti nuk respektohen?

Ai mund ta thrasë Policin (numrat e telefonit faqe 10). Ai person, që nuk e respekton masën për mbrojtje bëhet i dënueshëm edhe Policia mund ta merr në ruajtje për 24 orë (pyetje 37). Personi rrezikuar mund ta bëjë një kërkesë dënimi për prishje e qetësisë së shtëpisë. Mosrespektimi i masës për mbrojtje mund të jetë një arsye për zgjatjen e saj (pyetje 31).

26 A marrin personat rrezikuar këshillim?

Po. Një konsultore për viktime hynë së shpejti në kontakt me personin rrezikuar, më vonë 3 ditë pas urdhërimit e një mase për mbrojtje. Nëse dëshirohet një bisedë këshillimi, mundin të verifikohen hapat nevojë të ardhshëm me një person të kualifikuar zbashku. Biseda këshillimi do mbahet munsishtë në gjuhën amtare, eventualisht me një përkthyes. Këshillimi është falas.

27 A kontaktohet edhe personi i cili rrezikon?

Po, edhe personi i cili rrezikon kontaktohet. Zbashku me personin kualifikuar kthjellohet me cilën terapi ose masë sjellja e dhunshëm mund të shmanget në të ardhmen dhe cila sjellje në situata konflikti mund të mësohet. Këshillimi është falas.

28 Çfarë mund të bëjë në të ardhmen një person i cili rrezikon për ta shmangur dhunën?

Ai mund ta shfrytëzon ndihmën këshillimore vullnetare të institucionit manneburo. Institucioni manneburo shqyrton, cila rrugë në situatën konkrete është e dobishëm dhe shkakton shmangje të dhunës.

Institucionet zbatimi kanë zhvilluar një program për mësim „partneriteti pa dhunë“ (PoG), ku meshkujve në grup i jepet mundësia, ti bashkëbisedojnë faktoret që shkaktojnë dhunë dhe ti mësojnë strategjitë për bashkëjetesën dhe kapërcimin e konflikteve pa dhunë. Institucioni „manneburo zuri“ ofron edhe këshillime individuale dhe një grup stërvitje. Me gra të cilat rrezikojnë mbahen bisedimet individuale në institucionet zbatimi.

29 Çfarë mund të bëjë një viktimë, nëse ajo shkakës të dëbimit nuk ka të holla?

Nëse personi dëbuar është i detyruar të kujdeset për shpensimet të jetesës e familjes, duhet ai ti siguroje të hollat nevojshëm për kohëzgjatjen e dëbimit. Përndryshe ndihma sociale

përkohësisht i siguron të hollat nevojshëm. Zakonisht pastaj duhet të hapet një proces në gjykatën civile përgjegjës për përcaktimin e kontributit në shpenzime të jetesës. Në çdo rast rekomandohet kontakti me konsultoren për viktime përgjegjës (numrat e telefonit, adresat: faqe 10).

30 Çfarë ndodh nëse fëmijë jetojnë në shtëpi?

Nese fëmijët janë të rrezikuar drejtpërdrejt ose nese vijnë në shkallëzim të dhunës tek dorëzimi i fëmijëve, që kanë nevojë për kujdesje, ndalim kontakti zgjerohet tek fëmijët. Policia e transmeton dispozitën mbi masa për mbrojtje në autoritetin për kujdestari. Ai e verifikon, a ka nevojë për masa për mbrojtjen e fëmijëve, si p.sh. përkrahje të fëmijëve. Nëse fëmijët janë me një situatë rrezikut akut ose nëse nga përdorimi i dhunës kujdesja e fëmijëve nuk është e siguruar, atëherë Policia kujdeset për strehimin urgjent tyre. Njëkohsisht bëhet lajmërimi tek autoritetet për kujdestari, ku kapën masat e nevojshëm për mbrojtjen e fëmijëve.

Kërkesë për zgjatje e masave për mbrojtje GSG

31 A mund masat për mbrojtje të zgjasen?

Nëse personi rrezikuar ka nevojë për mbrojtje mbi 14 ditë, atëherë ai duhet vetë të vepronte: ai mundet mbrenda 8 ditëve nga marrja e urdhërit mbi masën për mbrojtje ta kërkojë zgjatjen në gjykatë për masa shtrënguese. Zgjatja mund të jetë deri 3 muaj.

32 Ku dhe si kërkohet zgjatja e masave për mbrojtje?

Personi rrezikuar mund në atë gjykatë për masa shtrënguese, që cekët në dispozitën për mbrojtje, ta bëjë një kërkesë bashkangjitur me dispozitën policore. Me shkrim duhet të arsyetohet në mënyrë të besueshme, pse rrezikimi akoma ekziston. Konsultoret mundin të ndihmojnë.

33 Si mund vazhdimësia e rrezikimit të arsyetohet në mënyrë të besueshme?

Nëse për mbrojtjen e personit rrezikuar është e nevojshme, atëherë mund të shprehët një zgjatje e masës për mbrojtje. Si vërtetim mund të sjellen p.sh. raporte mjekësor ose të terapeutit, cilët e vërtetojnë dëmtimin psikik ose fizik dhe e nënvizojnë nevojën e zgjatjes. Nëse një proces civil me kërkesën për masa preventive hapet në kuadër të mbrojtjes e martesës, ndarjes ose divorcit ose të mbrojtjes e personalitetit, zakonisht duhet të niset nga vazhdimësia e rrezikimit. Nëse rrezikuësi nuk e respekton masën për mbrojtje, edhe atëherë duhet të niset nga vazhdimësia e rrezikimit.

34 Si zhvillohet procesi për zgjatje para gjykatës?

Personi i cili rrezikon mirret në pyetje nga gjykata për masa shtrënguese. Pastaj mirret vendimi përfundimtar. Pastaj vendoset zgjatja e masës për mbrojtje dhe sasija e saj. Nëse

personi i cili rrezikon nuk vijnë në gjyqin, atëherë gjykata vendos përkohësisht në bazë të dosjes. Gjykata i njofton dy palët mbi vendimin e saj. Pa ankesë mbrenda 5 ditëve vendimi bëhet përfundimtar.

Kundër vendimit të gjykatës për masa shtrënguese mund të bëhet mbrenda 5 ditëve nga marrja/hapja e vendimit ankesa në gjykatën administrative Cyrih. Ankesa nuk ka efekt pezullues, dmth vendimi gjyqësor mbetet në fuqi dëri në vendimin e gjykatës administrative.

35 Çfarë, nëse rrethanat ndryshojnë?

Masat gjyqësore mund të ndryshohen nga gjykata për masa shtrënguese në bazë të një kërkesës, p.sh. nëse për dëbimin ka nevojë për një ndalim kontakti.

36 Sa kushton procesi gjyqësor?

Shpenzimet e një procesi për ankesë ose zgjatje para gjykatës për masa shtrënguese janë për palën, që humb, af. CHF 300.-- dëri CHF 600.--. Para gjykatës administrative zakonisht pala, që humb, paguan af. CHF 1'200.--. Nëse bashkohen procesi për ankesë me procesin për zgjatje, atëherë bëhet pak më shtrenjtë. Shpenzimet shpesh janë shpenzimet e palës kundërshtarë. Në rastin që ajo ka avokat, shpenzimet shpesh dalin disa qind franga. Nëse një person ose një familje jeton në minimumin e ekzistencës, në kërkesën e tij/saj gjykata nuk i kërkon ndërkohë shpenzimet. Ata kërkojnë, posa personi të ketë prap të holla.

Ruajtje

37 A mund Policia ta arrestojë një person i cili rrezikon?

Po. Policia mund ta arrestojë një person për 24 orë, nëse ai personin rrezikuar e rrezikon rëndë dhe menjëherë edhe rrezikimi nuk mund të largohet me një mënyrë tjetër ose nëse një ruajtje është e nevojshme për sigurimin e zbatimit të një mase për mbrojtje. Në kërkesën e Policiës gjykata për masa shtrënguese mund ta zgjatë ruajtjen dëri maksimal 4 ditë.

Kundër vendimit të gjykatës për masa shtrënguese mund të bëhet mbrenda 5 ditëve nga marrja/hapja e vendimit ankesa në gjykatën administrative Cyrih. Ankesa nuk ka efekt pezullues, dmth vendimi gjyqësor mbetet në fuqi dëri në vendimin e gjykatës administrative.

38 A mund Policia të urdhërojë të dy ruajtje edhe një masë për mbrojtje?

Po. Dëbimi, ndalim kontakti dhe/ose ndalim hyrja vlejné gjatë 14 ditëve prej urdhërimit. Ata vlejné edhe pas lirimit nga ruajtja ose nga burgimi hetimor ose pas lirimit nga një klinikë ose nga spitali.

II. Masa për mbrojtje gjatë hetimit penal

39 Kur urdhërohet burgimi hetimor?

Nese në bazë të rrethanave dyshohet, që personi rrezikuar në sjellje deklarate mund të vijjë nën presion nga personi i cili rrezikon, në raste të lëndimeve trupor ose të kërcënimeve urdhërohet burgimi hetimor. Ai mund të zgjase disa ditë, në krime më të rënda disa javë ose muaj. Viktimat duhet të informohen me kohë mbi lirimin. Nese janë urdhëruar njëkohësisht masa për mbrojtje para dhunës, duhet personi i cili ka përdorur dhunë ti përmbaje ata, nese ata në kohën e lirit nga burgimi akoma janë të vlefshëm.

40 A mund të urdhërohet burgimi hetimor në raste të kërcënimeve me vrasje?

Zakonisht urdhërohet burgimi hetimor në raste të kërcënimeve me vrasje të vërtetueshëm. Kohëzgjatja (e burgimit) varet nga rrethanat konkrete.

41 Çfar ndodh pas lirit nga burgimi hetimor?

Gjykatat për masa shtrënguese e kanë mundësin, në vend të burgimit hetimor të urdhërojnë masa zëvendësie. Ata mund të përmbajnë si masat për mbrojtje para dhunës ndalim qasje ose ndalim zone. Ata mund të përmbajnë edhe vizita mjeksore etj., nese me ate p.sh. krimi kërcënuar mund të pengohet.

III. Masa për mbrojtje në procese martesë dhe partneriteti

42 A ekziston mundësia, të urdhërohen masa për mbrojtje në një proces ndarje ose divorci?

Po, nese kërcënimet dhe ndjekjet janë vërtetuar. Këta masa për mbrojtje mund të përmbajnë ndalim qasje ose ndalim zone. Kush dëshiron një mbrojtje private të tillë, duhet atë ta kërkoje shprehimisht në procesin për ndarje ose divorc.

43 A mund një mbrojtje private të kërkohet edhe mes çiftit në bashkëjetesë?

Po. Pas procesit para gjyqtarit për paqe vazhdon një proces civil në procedur të thjeshtë. Ajo i nënshtrohet maksimës hetimore. Kush një mbrojtje të tillë e dëshiron, duhet ta kërkoje. Gjykata duhet në një masë të kufizuar të ndihmoj në mbledhje të dëshmive. Procesi është relativisht i shtrenjtë. Duhet të paguhën parapagesa (dëri CHF 3'000.00). Rekomandohet të kërkohet mbështetje nga një avokat.

IV. Numrat e telefonit dhe adresat

Numër urgjence i Policiës: 117

Konsultoret profesionale të Policiës (gjatë orarit të punës)

- Policia kantonale Cyrih
Tel. 044 247 30 61 Email: fachstelle.hg@kapo.zh.ch
 - Policia qytetare Cyrih
Tel. 044 411 64 12 Email: fachstelle.hg@stp.stzh.ch
 - Policia qytetare Winterthur
Tel. 052 267 64 69 Email: fachstelle.hg@win.ch
-

- Numër urgjence - Këshilla për të rriturit
Tel. 143 www.143.ch
 - Numër urgjence - Këshilla për fëmijë dhe të rinjtë
Tel. 147 www.147.ch Këshilla edhe me chat, SMS (falas), Facebook
-

GSG-Konsultoret për viktima

- bif Konsultore për këshilla dhe informacione për gra kundër dhunës në martesë dhe partneritet
Tel. 044 278 99 99 www.bif-frauenberatung.ch
 - Telefoni urgjencës për gra Winterthur - për gra të prekura nga dhuna
Tel. 052 213 61 61 www.frauennottelefon.ch
 - Konsultore telefoni urgjencës Cyrih për gra, që janë të prekura nga dhuna seksuale ndaj partnerit
Tel. 044 291 46 46 www.frauenberatung.ch
-

Konsultore për viktima

- Konsultore për viktima Cyrih, konsultore profesionale të fondacionit ndihma e viktimës Cyrih për burra dhe djemë, që janë të prekur nga dhuna e partneres si edhe për viktimat femër dhe mashkull tjerë të dhunës shtëpiake, si p.sh. vëllezërit dhe motrat, prindërit, të afërmit etj. (pa dhunë partneres)
Tel. 044 299 40 50 www.obzh.ch

Konsultoret për viktime për fëmijë dhe të rinjtë

- OKEY Winterthur
Tel. 052 266 90 09, në fundjavë: telefoni përherëshëm : 079 780 50 50
www.okey-winterthur.ch
- Grupi mbrojtjes për fëmijë dhe konsultorja për viktime i spitalit për fëmijë Cyrih
Tel. 044 266 76 46 www.kinderschutzgruppe.ch
- Castagna – Konsultore për fëmijë, të rinjtë femëror, që janë të shfrytëzuar seksualisht dhe gra, që kanë qenë të shfrytëzuara seksualisht në fëmijëri
Tel. 044 360 90 40 www.castagna-zh.ch
- Shtëpi për vajza Cyrih
Tel. 044 341 49 45
Email: info@maedchenhaus.ch www.maedchenhaus.ch
- Schlupfhuus
Telefoni halleve Tel. 043 268 22 68, këshilla Tel. 043 266 22 66
Email: info@schlupfhuus.ch www.schlupfhuus.ch

Projektet pilot të fjalimit të afër të fëmijëve për fëmijë

- KidsPunkt Winterthur
Tel. 052 266 90 48 ose 079 780 50 00 ose shkruaj një SMS
- KidsCare Cyrih, c/o Konsultorja Pinocchio
Tel. 044 240 41 08
Email: kidscare@pinocchio-zh.ch

Konsultore për burra të cilët rrezikojnë

- mannebüro züri
Tel. 044 242 08 88 www.mannebuero.ch

Konsultore për gra të cilët rrezikojnë

- Institucionet zbatimi/programet për mësim
Tel. 043 259 83 12 www.justizvollzug.zh.ch
-

Konsultoret tjera

- Konsultore strehë për gra Cyrih Oberland
Tel. 044 994 40 94
Këshilla edhe mes Email-it: info@frauenhaus-zo.ch
 - Telefoni halleve për fëmijë
Tel. 043 268 22 68
 - Numër urgjence për prindërit
Tel. 0848 35 45 55 (rrjet fiks - tarifë lokale)
Email: 24h@elternnotruf.ch www.elternnotruf.ch
 - FIZ Qendra e informacionit për gra nga Afrika, Azia, Amerika latine dhe Evropa lindore
Tel. 044 240 44 22 www.fiz-info.ch
 - Infodona – Konsultore për migrante dhe migrant
Tel. 044 271 35 00 www.stadt-zuerich.ch/infodona
-

Streha për gra (streha urgjence për gra të rrezikuara)

- Strehë për gra Cyrih
Tel. 044 350 04 04 www.frauenhaus-zuerich.ch
 - Strehë për gra Winterthur
Tel. 052 213 08 78 www.frauenhaus-schweiz.ch
 - Strehë për gra Cyrih Oberland
Tel. 044 994 40 94 www.frauenhaus-zo.ch
 - Strehë për gra Violetta për nënat me fëmijë
Tel. 044 291 08 70 www.frauenhaus-violetta.ch
-

Në manual për personat të kualifikuar ka i